

Nr. Prot. 057/B/18**VENDIMI Nr. 1263****Për****Implementimin e****Kodit 383 në Rrjetet e Komunikimeve Elektronike**

Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1), nenit 10 paragrafi 12), nenit 59, nenit 79 paragrafi 1) dhe 2), nenit 99, nenit 101 të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109 (*tutje referuar si – Ligji ose LKE*); dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (*Ref. Nr.Prot.054/B/17*) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- | | |
|-----------------------|----------|
| 1) z. Kreshnik Gashi, | Kryetar, |
| 2) z. Nijazi Ademaj, | Anëtar, |
| 3) z. Hazir Hajdari, | Anëtar, |
| 4) z. Bahri Anadolli, | Anëtar, |
| 5) z. Shqiprim Pula, | Anëtar |

në mbledhjen e 32-të të mbajtur më datë 02 Nëntor 2018, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe raportit të Departamentit për Komunikime Elektronike (*DKE*) për ecurinë e deritashme rreth procesit të implementimit të kodeve të caktuara nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (*ITU*), mori këtë:

V E N D I M

- I. Obligohen operatorët, të cilët nuk e kanë përfunduar implementimin e kodit E.164: +383 në rrjetet e telefonisë mobile ta implementojnë atë sa më shpejt që të jetë e mundur.
- II. Operatorëve, të cilët nuk e kanë përfunduar implementimin e kodit E.164: +383 në rrjetet e telefonisë mobile i shqiptohet vërejtja përfundimtare dhe në rast se më së voni deri më datë 15 janar 2019 nuk përfundon implementimi i kodit E.164: +383 në rrjetet e telefonisë mobile dhe ndërpriten kodet tjera do të zbatohet sanksioni ekonomik i përcaktuara në pikën III të këtij vendimi.

- III. Për çdo vonesë në përmbushjen e obligimeve pas afatit të përcaktuar në pikën II të dispozitivit të këtij Vendimi, ARKEP do të shqiptojë sanksionin ekonomik në shumë prej 10,000€ (dhjetë mijë euro) në baza mujore derisa të bëhet implementimi i plotë i kodit 383 dhe eliminohen kodet e deritashme.
- IV. ARKEP rezervon të drejtën që në të ardhmen të ndryshojë këtë vendim, nëse e shih të arsyeshme, konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe për çdo ndryshim në lidhje me vendimin, me kohë do të informojë palët e interesit.
- V. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIMI

Ligji, respektivisht neni 10 paragrafi 12 (*Kompetencat e Autoritetit*) përkufizon kompetencat e Autoritetit për menaxhimin e resurseve të fundme - hapësirën e numeracionit në komunikimet elektronike.

Neni 59 paragrafi 1) i Ligjit përcakton se numrat dhe seritë numerike mund të përdoren vetë në bazë të vendimit të ARKEP.

Pra, ARKEP, si Institucion përgjegjës për rregullimin e aktiviteteve të komunikimeve elektronike dhe atyre postare, me qëllim të implementimit sa më të shpejtë të kodeve shtetërore të caktuara nga ITU, me kohë ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme dhe ka pasur komunikime dhe takime intenzive me operatorët ashtu që realizimi i këtij qëllimi jetik për tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës të jetë sa më i lehtë dhe të gjitha sfidat eventuale gjatë këtij procesi të adresohen saktë përmes aplikimit të masave adekuate rregullatore dhe teknike.

Menjëherë, pas caktimit të kodeve nga ITU, ARKEP ka njoftuar palët e interesit dhe pas takimeve dhe komunikimeve të shumta, analizimit të komenteve dhe sygjërimeve të pranuar nga operatorët, me Vendimin Nr.935 (*Ref. Nr.Prot.011/B/17*) të datës 23 Shkurt 2017 ka miratuar dokumentin "*Plani i Migrimit i kodeve ekzistuese +377, +381 dhe +386 në kodin telefonik shtetëror +383 të Republikës së Kosovës*" (tutje referuar si - *Plani i Migrimit*).

Plani i Migrimit ka specifikuar aktivitetet dhe afatet kohore, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur në vijim:

- 1) *Brenda periudhës kohore Shkurt-Mars 2017, ARKEP do të njoftojë ITU-në lidhur me Planin e Numeracionit si dhe kodet e caktuara për ofruesit e shërbimeve (MNC dhe ISPC) sipas formave standarde të publikuara nga ITU.*
- 2) *Më së voni deri më 01 Qershor 2018 duhet të përfundojë në tërësi implementimi i kodit E.164: +383 dhe ndërpriten të gjitha kodet tjera (+377, +381 dhe +386), të cilat përdoren nga rrjetet e telefonisë fikse dhe mobile (Të mos origjinohen dhe terminohen thirrje në këto kode).*

- 3) *Deri më 31 Dhjetor 2018 duhet të përfundojë në tërësi implementimi i kodit për rrjetat mobile MCC: 221.*

Më datë 15 Mars 2017, ARKEP i ka dërguar shkresë (Ref. Nr.Prot.232/2/17) ITU-së, përkatësisht sektorit të Standardizimit (ITU-T), të shoqëruar me formularët përkatës sipas Rekomandimit ITU-T E.129 lidhur me:

- Prezentimin e Planit Kombëtar për kodin shtetëror +383 siç është specifikuar në nenin 8 të Rekomandimit E.129,
- Prezentimin e Numrave të rëndësisë së veçantë të lidhur me shërbimet emergjente dhe numrave tjerë të interesit publik, siç është specifikuar në Aneksin A të Rekomandimit E.129,
- Njoftimin për kodet MNC të caktuara sipas Rekomandimit ITU-T E.212 dhe
- Njoftimin për kodet ISPC të caktuara sipas Rekomandimit ITU-T Q.708.

ARKEP gjithashtu ka njoftuar ITU rreth caktimit të kodeve IIN (Issuer Identifiers Numbers), sidoqoftë këto kode ende nuk janë publikuar nga ITU në buletin operacional.

ARKEP gjatë procesit të implementimit të kodit, në vazhdimësi ka udhëzuar operatorët dhe ka kërkuar që:

- *Me intenzitet të shtuar të ndërmirren të gjitha shërbimet e nevojshme teknike dhe operative, në mënyrë që procesi të përmbyllet sa më shpejt,*
- *Të ndërmirren të gjitha veprimet e nevojshme për sensibilizimin e opinionit publik, respektivisht informimin e drejtë dhe saktë të qytetarëve të Republikës së Kosovës lidhur me implikimet që do të ketë kalimi në kodin e ri (p.sh. ndërrimi i SIM kartelave, etj.).*

Krahas aktiviteteve rreth implementimit të kodeve ARKEP gjithashtu ka hartuar Rregulloret e reja, të cilat ndërlidhen me kodin telefonik:

- i. Rregulloren për bartshmërinë e numrave për parapaguesit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, e cila është miratuar në mbledhjen e datës 09 Qershor 2017 të Bordit të ARKEP (Ref. Rregullorja Nr.33; Nr.Prot.043/B/17).
- ii. Rregullorja për Planin Kombëtar të Numeracionit për rrjetet e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës, e cila është miratuar në mbledhjen e datës 09 Qershor 2017 të Bordit të ARKEP (Ref. Rregullorja Nr.32; Nr.Prot.038/B/17).

Përkundër progresit të bërë, bazuar në përgjigjet e pranuar nga operatori Telekom i Kosovës sh.a. (Ref. Shkresat Nr.Prot.323/2/18 dt.05/04/2018; Nr.Prot.403/2/18 dt.27/04/2018 dhe Shkresa Nr.Prot.421/2/18; dt.10/05/2018) dhe IPKO Telecommunications LLC (Ref. Nr.Prot.268/2/18

dt.29/03/2018 dhe Nr.Prot.28/02/2018) në kërkesën e parashtruar nga ARKEP, vërehet se krahas progresit operatorët janë ballafaquar me sfida dhe si rrjedhojë kanë kërkuar shtyerjen e afatit për implementimin e kodit 383.

Pas shqyrtimit të kërkesave, në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësi, të cilat dalin nga Ligji bazë për Komunikimet Elektronike, Planin e Migrimit të miratuar nga ARKEP, marrë parasyshë përvojat e vendeve tjera, bazuar në kërkesat e operatorëve, si dhe me qëllim të menaxhimit adekuat të këtij procesi mjaftë kompleks, Bordi i ARKEP me Vendimin nr. 1198 (Ref. Nr.Prot.033/B/18) të datës 25 Maj 2018, ka përcaktuar afatet e reja për implementimin e kodit 383 dhe ndërprerjen e kodeve tjera, të cilat përdoren nga rrjetet e telefonisë fikse dhe mobile, afatet kanë qenë si në vijim:

- *Deri më datë 31 Tetor 2018 të përfundojë në tërësi implementimi i kodit 383 në rrjetet e telefonisë mobile dhe të ndërpriten kodet tjera;*
- *Brenda afatit kohor prej 30 ditësh, pra deri më datë 25 Qershor 2018 të ndërpritet kodi 381 në rrjetet e telefonisë fikse.*

Me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit në fjalë dhe përmbushjes së obligimit të operatorëve, më datë 03 Korrik 2018 ARKEP u dërguar shkresa dhe ka kërkuar nga operatorët e telefonisë fikse që të dërgojnë raporte, respektivisht të konfirmojnë lidhur me ndërprerjen e kodit 381 në këto rrjete dhe bazuar në përgjigjet e pranuar **të gjithë operatorët kanë konfirmuar se kanë ndërprer kodin 381 nga përdorimi në rrjetet e telefonisë fikse.**

Operatori IPKO Telecommunications LLC në shkresën e datës 27 Shtator 2018 (Ref. Nr.Prot.628/2/18) dërguar ARKEP sa i përketi kodit 383 ka njoftuar si në vijim:

- *Lidhur me kodin E.164: 383, është bërë funksionalizimi i tij si në terminimin e trafikut ndërkombëtarë ashtu edhe në origjinimin e trafikut ndërkombëtar, respektivisht prezentimin e numrit 383 për të dyja rrjetet: fikse dhe mobile.*
- *Më 20 Qershor 2018 është larguar plotësisht kodi E.164: 381, ku pas kësaj date thirrjet ndërkombëtare janë të pamundshme. Poashtu, janë organizuar fushata të ndryshme informuese lidhur me kodin e ri, të cilat do të vazhdojnë deri në ndërprerjen e plotë të kodit 386.*
- *Përkundër fushatave të ndryshme informuese, përqindja e trafikut të terminuar në kodin 383 krahasuar me kodin 386 ende nuk është në nivelin e dëshiruar. Sipas IPKO, nga 10 vendet kryesore, përqindja e trafikut në kodin 383 në muajin Shtator ka variuar nga 0.68% (Serbi) deri në 54.13% (Zvicërr), përderisa përqindja e trafikut të terminuar në kodin 386 ka variuar nga 45.87% (Zvicërr) në 99.32% (Serbi). Prandaj, sipas IPKO ndërprerja e kodit 386 do të shkaktonte zooglimin e të ardhurave, marrë parasyshë faktin se një pjesë e konsiderueshme e trafikut ende orientohet drejt këtij kodi.*
- **Marrë parasyshë çështjet e cekura më lartë, IPKO kërkon që kodi 383 të vazhdojë që të përdoret për thirrjet ndërkombëtare në hyrje deri në fund të dhjetorit 2019.**

Po ashtu operatori IPKO më datë 30 Korrik 2018 ka dërguar shkresë në ARKEP (Ref. NR.Prot.571/2/18), lidhur me kodet E.212: 221 dhe Q.708: 7-214, ku ka njoftuar si në vijim:

- Është ndërtuar një rrjet paralel të përshtatur me kodet e reja E.164, E.212 dhe Q.708 në mënyrë që të bëhen testimet me partnerët ndërkombëtarë. Me disa operatorë janë duke u bërë testime sipas procedurave të përcaktuara nga GSMA.
- Si sfida të paraqitura gjatë këtij procesi janë: operatorët ndërkombëtarë e cilësojnë vendin tonë si të vogël dhe jo atraktiv e që si rrjedhojë ka ngadalësimin e realizimit të marrëveshjeve, pastaj mos-alokimi i kodit E.118, i cili është i rëndësishëm për porositjen e SIM kartelave të reja. Gjithashtu adresat e rrjetit bërthamë (core network addresses dhe Global Title) të cilat fillojnë me E.164:386 duhet të ndërpriten së bashku me kodin E.212, pra zëvendësimi i tyre duhet të bëhet në të njëjtën periudhë.
- **Marrë parasyshë çështjet e cekura më lartë, IPKO kërkon që ndryshimi i kodeve E.212, Q.708 si dhe E.164:386 në "Core network addresses" dhe "Global Title" të shtyhet deri në fund të dhjetorit 2019.**

ARKEP më datë 28 Shtator 2018 ka pranuar shkresë (Ref. ARKEP Nr.Prot.630/2/18; TK Nr.Prot.01-4065/18) nga Telekom i Kosovës sh.a. (tutje referuar si - TK), përmes së cilës ka dhënë informacione rreth ecurisë së deritashme për implementimin e kodeve të caktuara nga ITU dhe sfidat, me të cilat është duke u ballafaquar:

- Ndërprerja e terminimit të trafikut derjt 381 është kryer në tërësi, me përjashtim të trafikut nga Serbia, i cili vjen në formatin pa CC.
- Sa i përket ndërprerjes së trafikut në kodin 377 janë paraqitur pengesa pasi që Monako Telekom i ka kërkuar bashkëekzistencën e kodeve 383 dhe 377 deri në dekomisionimin e plotë të MCC 212, kërkesë kjo e cila ka dalë nga Rregullatori i Monakos (DCE).
- Ndërprerja e prezentimit të thirrjeve dalëse me 381 është kryer në tërësi.
- Ndërprerja e prezentimit të thirrjeve dalëse me 377 nuk është përfunduar, megjithë faktin se ka pasur tentativa të ndryshme për improvizime.
- Sa i përket implementimit të kodit E.212: 221, marrë parasyshë nevojat për investim në rrjet dhe sfidat e paraqitura TK kërkon që afati i përcaktuar nga ARKEP të shtyhet.
- **Marrë parasyshë çështjet e cekura më lartë, Telekom i Kosovës kërkon që të koordinojë aktivitetet me Rregullatorin e Monakos dhe të shtyj afatin e implementimit.**

Për të diskutuar komentet/shkresat e pranuar, DKE dhe DL më datë 23 Tetor 2018 kanë mbajtur takim me operatorët IPKO dhe Telekom i Kosovës sh.a., të cilët kanë njoftuar rreth vështërsive të paraqitura në procesin e implementimit të kodeve.

Bazuar në ecurinë e deritashme rreth implementimit të kodeve të caktuara nga ITU, sqarimeve të dhëna më sipër si dhe raporteve të dorëzuara nga operatorët konstatohet se:

- Përmbushja e objektivave të caktuara me Planin e Migrimit dhe Vendimin nr.1198 të ARKEP që deri më 31 Tetor 2018 të përmbillet implementimi i kodit E.164: 383 dhe ndërpriten kodet tjera, nuk është arritur plotësisht nga të gjithë operatorët;
- Në procesin e implementimit të kodeve të caktuara nga ITU, operatorët janë duke u ballafaquar me disa sfida të ndryshme. Në veçanti Telekom i Kosovës, përveç tjerash është duke u ballafaquar edhe me probleme financiare, megjithatë kjo nuk duhet të përbëjë arsye për mos implementim të plotë të kodit shtetëror telefonik.

Prandaj, në funksion të zbatimit të detyrave dhe përgjegjësi, të cilat dalin nga Ligji bazë Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike, Planin e Migrimit të miratuar nga ARKEP, marrë parasysh përvojat e vendeve tjera si dhe me qëllim të menaxhimit adekuat të këtij procesi mjaft kompleks, Bordi i ARKEP ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 02/11/2018

Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Kreshnik Gashi
Kryetar i Bordit

Aktvendimi i dërgohet:

- Kuvendi i Kosovës, Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregëti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
- Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik,
- Operatorëve (ndërmarrësve) të rrjetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike;
- Departamentit Ligjor,
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike,
- Arkivës së Autoritetit